

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me zyrtaren ligjore, Hikmete Veliu-Pajaziti, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. D nga K, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M. M për veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP. II.nr.1006/2014, e datës 13.05.2014, e sipas marrëveshjes për pranimin e fajsisë të datës 28.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, më datë 28.07.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa, më datë 07.08.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.D, nga babai Rr dhe nëna Z, r lindur C, i lindur më datë në K, ku edhe jeton, në rr. “” pn., i maruar, baba i dy fëmijëve, me punë të përkohshme në Zvicër, me gjendje të mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 27.04.2014, rreth orës 13.15 min., në fsh. K, K. e Gj, për shkak të një mosmarrëveshje në komunikacion, lehtë e ka lënduar të dëmtuarën L. I, në atë mënyrë që, derisa bashkëshorti i të dëmtuarës, S.K, duke drejtuar automjetin e tij në rrugën magjistrale Gjilan-Kamenicë, me të arritur afër restorantit “...”, kishte hyrë në tejkalim të një veture të markës “...”, me targa të regjistrimit ..që e drejtonte i akuzuari B, i cili gjatë tejkalimit nga vetura tjetër kishte rritur shpejtësinë lëvizjes me automjet dhe kishte rrezikuar vozitësin tjetër, me ç’rast, pas tejkalimit, vozitësi S.K. e ka ndalur automjetin e tij, pastaj, edhe B. Di, të cilët menjëherë kanë filluar të fyhen mes vete dhe pasi situata ishte acaruar, nga automjeti ka dalur e dëmtuara, e cila ka intervenuar për t’i ndalur, me ç’rast, i akuzuari me duar e ka shtyrë të dëmtuarën dhe e ka rrëzuar për toke, për çka, ajo ka pësuar lëndime të lehta trupore, për shkak të të cilave është detyruar të kërkojë ndihmë mjeksore në Emergjencën e Spitalit Rajonal në Gj.

- me çka, ka kryer veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-së, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

E G J Y K O N

Të akuzuarin B. D, me Dënim Burgu në kohëzgjatje prej 80 (tetëdhjetë) ditësh, i cili dënim, me pëlqimin e të akuzuarit, në mbështetje të **nenit 47 të KPRK-së**, do t’i zëvendësohet në **Dënim Gjore**, në shumë prej **1000 (një mijë) €**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t’a paguajë në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin e zëvendësuar me gjobë, ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë, ai do të revokohet dhe i akuzuari do t’i mbajë 80 ditë burgim

Pala e dëmtuar, , udhëzohet në kontest juridiko-civil për kompensimin e dëmit.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe **paushallin gjyqësor** në lartësi prej **30 (tridhjetë) €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në bazë të Ligjit për kompensimin e viktimave neni 39 par.3 nën par. 3.1, të paguajë taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) €

Arsy etim

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjiilan, ka paraqitur aktakuzën, PP. nr.1006/2014, e datës 13.05.2014, kundër të akuzuarit B.D., për veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritot sipas ligjit.

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, përmes prokurorit të shtetit, Ismet Ukshini, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, av. M. M.

Prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur më datë 28.07.2017, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga Kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, prokuroria, e ka negociuar duke zbatuar në përpikëri dispozitat ligjore me të cilat është e rregulluar çështja e arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, i pandehuri së bashku me mbrojtësin e tij kanë qenë prezentë, në gjendje të mirë shëndetësore, i kanë kuptuar të drejtat dhe obligimet e marrëveshjes, si dhe, pasojat dhe benefitet të cilat rrjedhin nga kjo marrëveshje. Andaj, kërkojmë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP. nr. nr.1006/2014, e datës 28.07.2017,

Mbrojtësi i të pandehurit, av..., deklaroi se kërkesën për arritje të marrëveshjes e kanë paraqitur pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e tij, andaj, mbetet në tërësi pranë kësaj marrëveshje dhe kërkon nga gjykata që ta pranojë atë në tërësi.

I akuzuari, , deklaroi se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësit të tij, pasi që këtë marrëveshje e kanë arritur pas konsultimeve të mjaftueshme dhe pas njoftimit lidhur me pasojat dhe benefitet e kësaj marrëveshje, duke u zotuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm që të mos bie ndesh me ligjin.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët se pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, nuk i lejohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, e as prokurorit të shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, është përndarë për veprën në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës, duke qenë e bindur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK -së.
Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 605/2014, më datë 07.08.2017**

**Zyrtarja ligjore,
Hikmete Veliu-Pajaziti**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: *Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi.*